ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***Kuvendi Komunal Prizren***

Për Aktivitetin e Prokurimit: ***622-20-3121-5-1-1***

Sa i përket tenderit për ***Ndërtimi i rrugës Serbicë e poshtme - Serbicë e epërme në Prizren***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Gurëbardhi SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Abedin Rexha p.n
(Adresa)

Klinë — *32000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049868527 —
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Hasan Gashi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

gurebardhi@gmail.com
Adresa elektronike)

05.01.2021
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar GURËBARDHI Klinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftimi për kontratë – 24.06.2020 *B58 Njoftimi mbi vendimin e AK – 30.09.2020* *B58 Njoftimi mbi vendimin e AK – 14.12.2020*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1
Neni 6
Neni 7
Neni 59
Vendimi 984/20 i Organit Shqyrtues të Prokurimit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Kronologjia e fakteve

1. Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit (tutje: Autoriteti) ka publikuar njoftimin për kontratë me datë 24/06/2020.
2. Me datë 30/09/2020 përmes platformës së e-prokurimit Autoriteti ka publikuar Njoftimin për Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilën ka rekomanduar për dhënie të kontratës ofertën e Gurëbardhi SHPK.
3. Pas kësaj janë ankuar dy kompani në OSHP, e cila e ka kthyer tenderin në rivlerësim. Më datë 14/12/2020 AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës një operator tjetër, Seferi-Co SHPK & Daut Gashi B.I. & Bamirs me çmim dukshëm më të lartë se i Gurëbardhi SHPK, 425,051.44 euro.
4. Më 21/12/2020 është dorëzuar kërkesa për rishqyrtim, e cila është refuzuar më datën 24/12/2020, ku AK ka lënë në fuqi vendimin e saj të marrë më 14/12/2020.

II. Shqyrtimi dhe analiza

Operatori i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe duhet shpallur i papërgjegjshëm pasi që nuk ka resurset humane dhe teknike sipas dosjes së tenderit.

1. Nga qasja në dokumente kemi vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm shumë arsye të cilat janë të listuara më poshtë:
   a. Kërkese e dosjes së tenderit ka qenë që OE të ketë 20 punëtorë të profilit adekuat për realizimin e kontratës. OE i rekomanduar ka dorëzuar një listë të ATK-së ku janë të paraqitur 27 punëtorë, mirëpo ka dorëzuar vetëm 21 kontrata. Prej këtyre 10 punëtorë nuk janë të profilit adekuat për realizimin e kontratës, pasi qe 4 janë janë punëtorë administrate, 3 menaxhera dhe 3 ekonomista. Pasi të hiqen këta mbeten vetëm 10 punëtorë që janë adekuat për realizimin e kontratës, që nuk janë të mjaftueshëm pasi kërkesa ka qenë për 20 punëtorë të profilit adekuat. OE i rekomanduar duhet të shpallet i papërgjegjshëm për këtë arsye. Kjo pasi që është e qartë se me këtë numër të punëtorëve nuk mund të bëjë ekzekutimin e duhur të obligimeve kontraktore. Pretendimi i AK është se OE i rekomanduar ka mjaftueshëm numër të punëtorëve. Kjo është e pasaktë pasi kërkesa ka qenë për 20 punëtorë të profilit adekuat. Është e vërtetë që OE i rekomanduar i ka 27 punëtorë në listë, mirëpo vetëm 10 punëtorë janë të profilit adekuat. AK nuk ka kërkuar vetëm një listë të thjeshtë, por shprehimisht e ka theksuar që punëtorët duhet të profilit adekuat për realizimin e kontratës. Prandaj arsyetimi i AK është i pabazuar.
   b. Tek kërkesat për staf profesional është kërkuar gjeodet i licencuar. OE i rekomanduar ka prezantuar kontratën me personin Rilind Elshani, cili në të njëjtën kohë ka kontratë me OE ISeferi. Në dy kontratat orari i punës është 8 orë në ditë, nuk ka mundësi që i punësuari të punojë për të dy kompanitë në të njëjtë kohë me kontratë primare me orar tetë orë në ditë. Kontrata e gjeodetit me Seferi-Co edhe pse ka titullin marrëveshje bashkëpunimi, është kontratë e rregullt pasi kontrata ka hyrë në fuqi më 14.09.2020, që është para se të dihet se kush do të jetë OE i rekomanduar. Pasi kontrata me ISeferi ka datë më të hershme, atëherë kjo është kontrata që vlen dhe për këtë arsye OE i rekomanduar ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm. Për këtë pretendim AK është arsyetuar me një emër të një tjetër punëtori, i cili nuk ka qenë i përmendur në kërkesën për rishqyrtim. Sidoqoftë janë dy OE që kanë kontratë me personin Rilind Elshani, dhe pasi kontrata me ISeferi është më e hershme, kontrata me Seferi-Co nuk mund të vlejë dhe kjo llogaritet se Seferi-Co nuk ka dorëzuar fare gjeodet, gjë që e bën të papërgjegjshme ofertën e tij. Kontrata me Seferi-Co nuk është parakontratë pasi askund nuk kushtëzohet se ajo hyn në fuqi nëse fitohet tenderi. Për me tepër kontrata ka hyrë në fuqi më 14.09.2020 e cila është data e dorëzimit të ofertave.
   c. OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm pasi që ka përdoru listën e pajisjeve të një operatori tjetër që po ashtu ka qenë ofertues në këtë tender. Pra kompanija ISeferi SHPK ka përdorur pajisjet e Seferi-Co. Ky rast edhe nga precedentët e

OSHP-së dhe edhe nga vet fryma e Ligjit të Prokurimit Publik është i ndaluar pasi që konsiderohet se i njëjti person ka dorëzuar dy oferta. Në rastin konkret të dy kompanitë përveç se janë të regjistruara si dy të ndryshme kanë ekzaktësisht të gjitha të dhënat e njëjta duke përfshirë edhe pajisjet e tyre. Sipas vendimit 984/20 të OSHP-së ka marrë pjesë edhe në ofertën e kompanisë ISeferi SHPK, pasi të gjitha pasjisjet që ISeferi ka dorëzuar në ofertën e saj janë të Seferi-Co. Sipas vendimit të OSHP-së kjo cilësohet se e njëjta kompani ka marrë pjesë në dy oferta dhe të dyja duhet të cilësohen si të papërgjegjshme.

Sa i përket pretendimit te OE ankues OE Ada Consulting Group sh.pk. & Krapi Com që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se marrëveshja për shfrytëzim të mjeteve të cilën e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë është e lidhur me një OE i cili është njëkohësisht edhe ofertues në këtë aktivitet të Prokurimit pra me kompaninë ISEFERI sh.p.k, si dhe mos nënshkrimi nga pronari mirëpo nga një person i pa autorizuar. Paneli Shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues profesional te prokurimit konstaton se ky pretendim është i bazuar, pasi që OE ISEFERI është ofertues në këtë tender dhe nuk ka te drejt të jetë pjesë e ndonjë oferte tjetër për të njëjtin tender. Marrëveshja për shfrytëzim të mjeteve është pjese e tenderit, dhe kompania ISEFERI sh.p.k me rastin e lidhjes se marrëveshjes me OE te rekomanduar është bërë pjesë e ofertës se tij. Ne lidhje me këtë çështje merret për bazë interpretimi i dhënë nga KRPP, për rastin e ngjashëm ku parimi ligjor është i njëjtë - Pyetjet e shpeshta, Pyetja nr. 48. Gjithashtu, nëse një Operator Ekonomik në një aktivitet te prokurimit të ndarë në LOT-e, në njërin LOT konkurron si i vetëm, ndërsa ne një Lot tjetër ne grup, kjo kompani nuk mund te dorëzoj deklaratën qe konfirmon se ai anëtar nuk është duke marre pjese ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në të njëjtën procedurë të prokurimit.

2. Në vendimin që ka marrë OSHP-së, situata është e njëjtë ISeferi, ka ofertuar vetë në tender dhe i ka dhënë pajisjet në shfrytëzim OE të rekomanduar në atë tender. Në tenderin e AK Komuna e Prizrenit, OE i rekomanduar është Seferi-Co i cili i ka dhënë me qera pajisjet e saj kompanisë ISeferi SHPK dhe sipas vendimit të OSHP-së OE i rekomanduar është bërë pjesë e ofertës së ISeferi dhe sipas kësaj OE i rekomanduar nuk ka mundur të dorëzojë deklaratën që konfirmon se nuk merr pjesë në një grup tjetër në procedurën e njëjtë të prokurimit. Si rezultat duhet që të dy operatorët të cilësohen si të papërgjegjshëm duke u mbështetur në vendimin 984/20 të OSHP-së.

Shpallja si të papërgjegjshëm e ofertës tonë ishte e panevojshme dhe në dëm të interesit publik

3. Kërkesa në dosjen e tenderit ishte që ne mes të tjerash të dorëzohej edhe një buldozer apo rrafshues i tipit 15 ton. Në anën tjetër në ofertën tonë është dorëzuar një buldozer me tonazh pak më të madhe sesa ajo që është kërkuar në dosjen e tenderit. Marrë për bazë se kjo kërkesë e dosjes së tenderit nuk është respektuar në tërësi, ne konsiderojmë se kjo pajisje e cila është dorëzuar gabimisht me tonazh më të lartë sesa ajo që është kërkuar në dosje të tenderit duhet të shihet në dritën e një devijimi të vogël teknik i cili nuk ka ndonjë ndikim material në zbatimin e kontratës. Përkundrazi, pajisjet e konsorciumit tonë dëshmojnë se në krahasim me secilën ofertë tjetër përveç se jemi më të lirë po ashtu më së miri i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

4. Në fakt krahasuar me lëshimet që kanë ofertat e operatorëve të tjerë, ky me tonazhën e rrafshuesit mund të interpretohet si përmbushje dhe tejkalim i kërkesës pasi që një operator që ka buldozer të tonazhës së lartë është qesharake të mos ketë ato me tonazh më të ulët. Andaj duke marr parasysh se oferta jonë është dukshëm më e lirë sesa ajo e operatorit të rekomanduar në ju lusim që ta keni parasysh këtë çështje në atë mënyrë që të mbroni interesin publik dhe të shpërblehet oferta më e lirë në këtë rast. Prandaj duke marrë parasysh të gjitha dëshmitë më lartë kërkojmë nga OSHP që të marrë këtë vendim:

VENDIM

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik Gurëbardhi SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës Serbicë e poshtme - Serbicë e epërme në Prizren", me numër të prokurimit 622-20-3121-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Prizren.

II. **ANULOHET**, vendimi për dhënien e kontratës dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*